



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 224/5 Prot

Tiranë, më 02/4 /2021

VENDIM

Nr. 20, datë 02. 4 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica” (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 224 Prot., datë 28.01.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet e-mail-it datë 02.12.2020, depozituar në adresën elektronike [suela.huta@parlament.al](mailto:suela.huta@parlament.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion kopje e opinioneve/rekomandimeve të dhëna nga EURALIUS për projektligjet/ligjet, si vijon:

- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarëve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar;
- “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”;

- "Për shërbimin e Provës";
- "Për tarifrat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë";
- "Për provimin e shtetit për profesionin e juristit" dhe "Për strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë";
- "Për ndihmën juridike";
- "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarrimor privat", të ndryshuar.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim, "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 224/1 prot., datë 15.02.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me ankesën e paraqitur.

Në vijim, Autoritetit Publik me shkresën nr. 537/1 Prot., datë 22.02.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 224/2 Prot., datë 22.02.2021, ka informuar ndër të tjera se: "*...Në përputhje me nenin 15, shkronja "c", "Nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës", të LDI, Kuvendi i Shqipërisë i është drejtuar për konsultim EURALIUS lidhur me konfidencialitetin e përmbajtjes dhe bërjen apo jo publike të opinionëve/rekomandimeve të dhëna nga EURALIUS për projektligjet/ligjet. Kuvendi, bazuar edhe në opinionin e dhënë nga EURALIUS, ka informuar Qendrën "Res Publica" se mbështetur tek të dhënat kontraktuale çdo korrespondencë apo mendim ligjor që lidhet me projektin, duhet të konsiderohet dhe mbetet konfidencial.*"

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin nr. 224/3 Prot., datë 08.03.2021, duke theksuar ndër të tjera se: "*...Ky qëndrim i mbajtur nga ana e autoritetit publik është i gabuar. Informacioni i kërkuar nga ana jonë lidhet me opinionet/rekomandimet e dhëna nga EURALIUS në lidhje me projektligje/ligje, pra nuk kanë të bëjnë me të dhëna konfidenciale sa i përket marrëdhënies kontraktuale që ka Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me EURALIUS.*"

Po në këtë shkresë, autoriteti publik, informon se të gjitha opinionet apo rekomandimet publike të dhëna nga EURALIUS, mund t'i gjeni në faqen e internetit të EURALIUS. Informacioni i kërkuar nga ana jonë është publik, dhe lidhet pikërisht me opinionet apo

*rekomandimet publike të dhëna nga EURALIUS për projektligjet dhe/ose ligjet, dhe si i tillë duhet të jepet nga ana e autoritetit publik.*

*Gjithashtu theksojmë se, duke qenë se ligjet janë të detyrueshme për tu zbatuar në vendin tonë, është në interes të publikut të informohet në lidhje me procesin e konsultimit dhe miratimit të tyre nëpërmjet një procedure transparente nga ana e autoriteteve kompetente”.*

Në vijim, Zyra e Komisionerit kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar në lidhje me këtë ankesë.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 877 Prot., datë 25.03.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 224/4 Prot., datë 25.03.2021, argumentoi qëndrimin përfundimtar duke sqaruar ndër të tjera se: “...Në vijim të shkresës nr. 146/20 Prot., datë 17.11.2020, Qendra “Res Publica”, bazuar në LDI, në nenin 17 pika 6 “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit”, propozon mbulimin e informacioneve konfidenciale dhe vënien në dispozicion të pjesës tjetër të informacionit.

*Sikurse jeni në dijeni, në përputhje me nenin 15 shkronja “c”, të LDI, “Nevoja për t’u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës”, Kuvendi i Shqipërisë i është drejtuar për konsultim “EURALIUS”, lidhur me konfidencialitetin e përmbajtjes dhe bërjen ose jo publike të opinionëve/rekomandimeve të dhëna nga EURALIUS për projektligjet/ligjet.*

*Në përgjigje të kësaj kërkesë, EURALIUS, informon mbi qëndrimin e IRZ-së, në pozicionin e kontraktorit kryesor të EURALIUS si dhe Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri lidhur me këtë çështje ku sqarohet se çdo korrespondencë apo mendim ligjor i dhënë nga EURALIUS, duhet të konsiderohet dhe mbetet konfidencial, pasi EURALIUS i jep këto opinione, mendime, komente për projektligje/ligje gjatë procesit të konsultimit të tyre, bazuar në një marrëveshje kontraktuale që ka me IRZ dhe Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, sipas të cilës çdo korrespondencë apo mendim ligjor i dhënë, duhet të konsiderohet dhe mbetet konfidencial, jo vetëm nga ana e palëve në marrëveshje por edhe nga përfituesit. Në këtë rast, Kuvendi i Shqipërisë është një nga institucionet kryesore përfituese të këtyre opinionëve të dhëna nga EURALIUS.*

*Sa më sipër, duke respektuar qëndrimin e EURALIUS, IRZ-së dhe Delegacionit të Bashkimit Europian mbi këtë çështje, Kuvendi si institucion përfitues merr përsipër të ruaj konfidencialitetin e çdo informacioni pavarësisht nga forma, e shkruar apo e folur dhe si rrjedhojë jemi të mendimit se opinionet/rekomandimet e dhëna nga EURALIUS për projektligje/ligje, duhet të konsiderohen dhe mbetë konfidenciale.”*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Autoriteti Publik, ka sqaruar vetëm se ka kërkuar nga EURALIUS opinion në lidhje me vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni. Gjithashtu, ka informuar mbi qëndrimin e

IRZ-së, në pozicionin e kontraktorit kryesor të EURALIUS si dhe Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri lidhur me këtë çështje ku sqarohet se çdo korrespondencë apo mendim ligjor i dhënë nga EURALIUS, duhet të konsiderohet dhe mbetet konfidencial pasi EURALIUS i jep këto opinione, mendime, komente për projektligje/ligje gjatë procesit të konsultimit të tyre, bazuar në një marrëveshje kontraktuale që ka me IRZ dhe Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumenteve bashkëlidhur, konstatohet se Autoriteti Publik, nuk ka vendosur në dispozicion në cilësinë e provës kopje të kësaj marrëveshje apo çdo akt tjetër, duke mos provuar në këtë mënyrë se është përpara kufizimeve të nenit 17 të LDI.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e dokumentacionit nuk rezulton i bazuar në ligj. Për më tepër, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të opinioneve/rekomandimeve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tyre.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI në të cilën parashikohet se, “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këto kushte, informacioni i zotëruar nga Autoriteti Publik, i duhet vënë në dispozicion kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar parashikohet se, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 224 Prot., datë 28.01.2021 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 02.12.2020, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (kopje e opinioneve/rekomandimeve të dhëna nga EURALIUS për projektligjet/ligjet, si vijon:
  - “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
  - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;
  - “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarëve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar;
  - “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”;
  - “Për shërbimin e Provës”;
  - “Për tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”;
  - “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit” dhe “Për strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë”;
  - “Për ndihmën juridike”;
  - “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor privat”, të ndryshuar), brenda datës 13.4.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02.4.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

